



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2369 Prot.

Durrës më, 26/12 /2023

V E N D I M

Nr. 86 Datë 26/12 2023

PËR

"Për shpalljen e aplikimeve për anëtar të Këshillit të Etikës në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës"

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 44, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.685, datë 25.08.2010, 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", të ligjit nr.8480, date 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, neni 22, të Rregullores së UAMD-së, neni 16, të Vendimit nr.65, datë 15.12.2020, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Shpalljen e aplikimeve për anëtarë të Këshillit të Etikës në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Kandidatët për anëtarë të Këshillit të Etikës vetëkandidohen, ose propozohen nga Dekanati i Njesisë Kryesore përkatëse.
3. Kandidatët staf akademik duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për Kandidim (bashkëlidhur);
 - b) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale (bashkëlidhur);
 - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.
4. Kandidatët student duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për Kandidim, (bashkëlidhur), shoqëruar nga të paktën 30 firma të studentëve që mbështesin kandidaturën;
 - b) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale (bashkëlidhur);
 - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.

5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data 3.01.2024 deri në datën 10.01.2024.
6. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar, Sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat për stafin akademik që kandidon me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, dhe të dhënat e studentëve që kandidojnë me Kryesekretarinë e Fakulteteve përkatëse, përcjellë listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatin Akademik.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - ✓ Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

